

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap - Kz nr. 246 / 2010

25 maj 2012

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarës së Gjykatës Supreme Marije Ademi, gjyqtarit të Gjykatës Supreme Salih Toplica, gjyqtarit të EULEX-it Tore Thomassen dhe gjyqtarës së EULEX-it Dr. Anne Kerber si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga këshilltari ligjor Adnan Isufi në cilësi të procesmbajtësit,


në lëndën penale kundër të pandehurve:

B. H. me shtetësi të Kosovës, në paraburgim prej datës 21 janar 2008, dhe

S. Q. me shtetësi të Kosovës, në paraburgim prej datës 21 janar 2008,

Të dytë të dënuar me Aktgjykimin P. Nr. 488 / 08 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 22 shtator 2009 për veprat penale të vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 147 paragrafët 4, 9, dhe 11 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), të lëndimit të rëndë trupor në kundërshtim me nenin 154 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim me nenin 291 paragrafët 1 dhe 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së; dhe të dytë të dënuar me burgim afatgjatë me njëzet e pesë (25) vjet burgim sipas nenit 37 dhe nenit 147, paragrafit 1, pikave 4, 9 dhe 11, lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe me dënim me burgim prej tre (3) vjetësh sipas nenit 154, par. 1, pikës 1, lidhur me nenin 23 të KPK-së si dhe me dënim me burgim prej tre (3) vjetësh sipas nenit 291, par. 1 dhe 5, lidhur me nenin 23 të KPK-së, pra në përgjithësi me një dënim unik të burgimit afatgjatë prej gjithsej njëzet e pesë (25) vjetësh, sipas nenit 71, par. 1 dhe 2, pikave 1 dhe 2 të KPK-së,

Duke vendosur mbi ankesat e ushtruara nga avokati mbrojtës **D. J.** më 27 prill 2010, nga avokati **M. H.** më 28 prill dhe më 21 maj 2010 në emër të të pandehurit **B. H.** dhe nga avokati **A. I.** në emër të të pandehurit **S. Q.** më 26 prill 2010, kundër Aktgjykimit P. Nr. 488 / 08 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 22 shtator 2009, dhe duke pasur parasysh Përgjigjen e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) të dhënë më 13 qershor 2010 si dhe Mendimin e Zyrës së Prokurorisë së Shtetit të Kosovës (ZPSHK), të dhënë më 13 shtator 2011,



Pas mbajtjes së scancës publike më datën 22 maj 2012, në praninë e palëve në procedurë dhe pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 24 maj 2012,

Në bazë të Nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

Ankesat e avokatëve mbrojtës të të pandehurve B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] Q [REDAKTUAR] kundër Aktgjykimit P. Nr. 488 / 08 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 22 shtator 2009, refuzohen si të pabaza me ndryshimin e pikës 3 të shkaktit të rrezikut të përgjithshëm, e cila konsumohet nga pika 1 – vrasje e rëndë.

Aktgjykimi vërtetohet sa i përket pjesës tjetër të tij.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në bazë të nenit 73, par. 1 të KPK-së. Paraburgimi ndaj të pandehurve B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] Q [REDAKTUAR] me këtë vendim vazhdohet derisa Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ap - Kz 246 / 10, i datës 25 maj 2012 të merr formën e prerë, por jo më gjatë sesa deri në skadimin e dënimit të caktuar përmes këtij aktgjykimi. Gjykata do ta nxjerrë një aktvendim të veçantë në bazë të nenit 393 të KPPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale në shkallën e dytë do të mbulohen së bashku nga të pandehurit në bazë të neneve 99, 100 dhe 103 të KPPK-së.

ARSYETIM

I. Procedura e deritanishme


Më 24 shtator 2009, rreth orës 2:00 të mëngjesit ndodhi një shpërthim goxha i fuqishëm në katin përdhes të objektit që ndodhet në Bulevardin Bill Clinton, në zonën e Dardanisë në Prishtinë. Si pasojë e shpërthimit, dy persona – shtetas të Kosovës humbën jetën ndërsa disa të tjerë u lënduan.

Më 12 gusht 2008, në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës është ngritur Aktakuza PPN - KTR 697 – 7 / 07 - PP - KT 61 – 6 / 08 kundër të pandehurve.¹

Më 2 shkurt 2009, kjo aktakuzë është konfirmuar për pikat 2, 3 dhe 4 me Aktvendimin konfirmues KA Nr. 470 / 08. Pika e bashkimit penal është hedhur poshtë ndërsa procedura penale lidhur me këtë pikë është ndërprerë në bazë të nenit 316 të KPPK-së.²

¹ Pikat: bashkim kriminal në kundërshtim me nenin 26, par. 1 të KPPK-së për të kryer vrasje të rëndë në kundërshtim me nenin 176, par. 4, 9 dhe 11, vrasje të rëndë në tentativë në kundërshtim me nenin 147 paragrafët 4, 9, dhe 11 lidhur me nenin 20 të KPPK-së dhe shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim me nenin 291 paragrafët 1 dhe 5 të KPPK-së (pika 1); vrasje të rëndë në kundërshtim me nenin 176, par. 4, 9 dhe 11, lidhur me nenin 23 të KPPK-së (pika 2); vrasje të rëndë në tentativë në kundërshtim me nenin 147 paragrafët 4, 9, dhe 11 lidhur me nenet 20 dhe 23 të KPPK-së (pika 3); dhe shkaktim të rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim me nenin 291 paragrafët 1 dhe 5 lidhur me nenin 23 të KPPK-së (pika 4).

² Dosja me ngjyrë të zejë e shënuar me numrin KA nr. 470 / 08 – nr. 469 / 08, P nr. 488.



Gjykimi ka filluar në muajin maj dhe ka zgjatur deri në muajin shtator 2009. Mbi tridhjetë dëshmitarë janë dëgjuar gjatë këtij gjykimi. Më 22 shtator 2009, Gjykata e shkallës së parë ka shpallur fajtorë të pandehurit Besnik Hasani dhe Shpend Qerimi për këto vepra penale:

- **Vrasje e rëndë** në kundërshtim me nenin 147 paragrafët 4, 9, dhe 11 lidhur me nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (pika e aktakuzës), për shkak se “më 24 shtator 2007, B. H. dhe S. Q. duke vepruar në bashkë-kryerje me njëri tjetrin si dhe me individë të tjerë identiteti i të cilëve akoma është i panjohur, kanë privuar nga jeta persona të tjerë për shkak të hakmarrjes së paskrupullt dhe motive të tjera të ulëta, duke vendosur dhe shpërthyer mjete të improvizuara eksplozive në katin përdhes të një objekti në Avenynë Bill Clinton, në Prishtinë, që ka rezultuar në vdekjen e N. M. dhe të P. S., dhe duke vepruar një gjë të tillë me qëllim kanë rrezikuar jetën e më shumë personave të tjerë.”
- **Lëndim i rëndë trupor** në kundërshtim me nenin 154 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPK-së. për shkak se “më 24 shtator 2007, B. H. dhe S. Q. duke vepruar në bashkë-kryerje me njëri tjetrin si dhe me individë të tjerë identiteti i të cilëve akoma është i panjohur, u kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore personave X. S., V. Z., L. N., G. S., E. H., N. H., F. B., L. K., dhe S. S. duke vendosur dhe shpërthyer mjete të improvizuara eksplozive në katin përdhes të një objekti në Avenynë Bill Clinton, në Prishtinë,” si dhe
- **Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm** në kundërshtim me nenin 291 paragrafët 1 dhe 5 lidhur me nenin 23 të KPK-së (pika 4 e aktakuzës për shkak se “më 24 shtator 2007, B. H. dhe S. Q. duke vepruar në bashkë-kryerje me njëri tjetrin si dhe me individë të tjerë identiteti i të cilëve akoma është i panjohur, duke vendosur dhe shpërthyer mjete të improvizuara eksplozive në katin përdhes të një objekti në Avenynë Bill Clinton, në Prishtinë, kanë shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve që ka rezultuar me vdekjen e dy personave, pikërisht të N. M. dhe të P. S., si dhe me lëndime të rënda trupore të X. S., V. Z., L. N., G. S., E. H., N. H., F. B., L. K., S. S., M. K., dhe të T. K., ndërsa dëme të konsiderueshme materiale edhe ndaj pronës, pikërisht të lokaleve C., B., U., S., O., P., N., K., F. C. dhe S.”.

B. H. dhe S. Q. janë dënuar me dënim unik prej njëzet e pesë (25) vjetësh burgim, në bazë të nenit 71 të KPK-së.³ I pandehuri i tretë është liruar në bazë të nenit 390, pikës 3 të KPPK-së.

Avokati mbrojtës A. I. ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë në emër të të pandehurit S. Q. më 26 prill 2010. Avokati D. ushtroi ankesë në emër të të pandehurit B. H. e cila u pranua më 27 prill 2010.

³ Gjykata e Qarkut i ka urdhëruar të dy të akuzuarit që t'i kompensojnë palët e dëmtuara për dëme të shkaktuara, dhe i ka urdhëruar ato që të ushtrojnë padi civile, në bazë të nenit 112, par. 2 të KPK-së. Të pandehurit janë urdhëruar që të paguajnë shpenzimet e procedurës sipas nenit 102, par. 1 të KPPK-së.



Avokati mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED] ushtroi dy ankesa në emër të të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED] më 28 prill dhe më 21 maj 2010. PSRK-ja paraqiti përgjigje ndaj këtyre ankesave më 1 qershor 2010 dhe Zyra e Prokurorisë së Shtetit të Kosovës paraqiti mendimin ndaj ankesave më 13 shtator 2011.

II. Parashtrirat e palëve

A. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED] në emër të të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED]

Mbrojtja ushtroi ankesë për shkak të:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 i KPPK-së;
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 405 i KPPK-së;
- Shkeljes së ligjit penal nga neni 404 i KPPK-së; dhe
- Vendimit mbi sanksionimin penal nga neni 406 i KPPK-së.

Avokati mbrojtës i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta lirojë të pandehurin në përputhje me nenin 390 paragrafin 3 të KPPK-së, ose ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në shkallë të parë për rigjykim. Në fund, mbrojtja kërkon lirimin e menjëhershëm të B [REDACTED] H [REDACTED].


Mbrojtja i referohet qëndrimit ofendues dhe të anshëm të kryetarit të trupit gjykues ndaj të pandehurit. Ai pohon se mënyra e komunikimit në mes gjyqtarit dhe prokurorit, dhe e tërë procedura penale ngrit dyshime. Ai po ashtu pohon se vulat në dokumentet e lëshuara nga prokuroria dhe gjykata janë të paqarta. Përveç kësaj, gjyqtari i konfirmimit të aktakuzës nuk ka vepruar në përputhje me nenin 264 të KPPK-së.

Mbrojtja pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale:

- Mbrojtja kundërshton ndryshimin e përbërjes së trupit gjykues.
- Aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në prova të papranueshme. Urdhri për ekspertizën e gjurmëve të eksplozivit në veturën 093 KS073 ishte dhënë në shkelje të nenit 176 të KPPK-së.
- Aktgjykimi i kundërshtuar tejkalon aktakuzën, pasi që arsyetimi shtjellon mbi 'rastin e vrasjes së trefishtë.
- Arsyetimi në aktgjykim është kundërthënës. Ekziston një mospërputhje e konsiderueshme sa i përket fakteve materiale në mes arsyetimit lidhur me përmbajtjen e procesverbaleve të dëshmitë të dhëna në procedurë dhe vetë këtyre procesverbaleve, në veçanti me dëshmitë e dëshmitarëve për shpërthimin dhe rrethanat e shpërthimit.

Mbrojtja pohon është bërë vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i këtyre rrethanave faktike:

- Shpërthimi dhe rrethanat e tij: gjykata e shkallës së parë gabimisht erdhi në përfundim se dëshmitë e dëshmitarëve V [REDACTED] Z [REDACTED], E [REDACTED] H [REDACTED], L [REDACTED] N [REDACTED] D [REDACTED] N [REDACTED] dhe I [REDACTED] kanë dhënë një përshkrim homogjen të ngjarjeve.
- Informatat e dhëna nga dëshmitarja M [REDACTED] I [REDACTED] gjykata e shkallës së parë gabimisht vlerësoi dëshminë e kësaj dëshmitareje, sidomos për shkak se gjykata nuk arriti t'i ballafaqojë ato me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, p.sh. [REDACTED] dhe Z [REDACTED] I [REDACTED]. Mbrojtja bind se F [REDACTED] S [REDACTED] tentoi ta drejtojë prokurorinë për t'i hequr qafe B [REDACTED] H [REDACTED] dhe S [REDACTED] Q [REDACTED].



- Informatat lidhur me vrasjen e trefishtë: dëshmitë e dëshmitarëve A [REDACTED] B [REDACTED] O [REDACTED] dhe Z [REDACTED] dhanë dëshmi të cilat janë në kundërthënie me ato të dhëna në gjykatë.
- Përgjimet telefonike dhe provat e tjera teknike: gjykata e shkallës së parë gabimisht vlerësoi marrëdhënien në mes M [REDACTED] I [REDACTED] dhe vajzave të saj, dhe marrëdhënien në mes B [REDACTED] H [REDACTED] dhe A [REDACTED] I [REDACTED]. Fakti se B [REDACTED] H [REDACTED] ishte në pushim mjekësor dhe se nuk e kishte përdorur veturën e inkriminuar është provuar me anë të dokumentacionit mjekësor dhe është vërtetuar me dëshmitë e dëshmitarëve.
- Alibia e B [REDACTED] H [REDACTED]: i pandehuri rikujton natën kritike në mënyrë të sinqertë, dhe alibia e tij është vërtetuar me disa dëshmi të dëshmitarëve.

Në fund, mbrojtja nuk konsideron se është e domosdoshme të shtjellohet më tutje mbi përcaktimin ligjor të veprimeve dhe mbi vendimin mbi sanksionimet penale, pasi që këto janë rezultat i shkeljeve të lartpërmendura.

B. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës D [REDACTED] J [REDACTED] në emër të të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED]

Mbrojtja pretendon në:

- Shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe
- Vendimin mbi sanksionimin penal.


Avokati mbrojtës i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta lirojë të pandehurin dhe ta lirojë atë menjëherë.

Mbrojtja pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale:

- Mbrojtja është penguar të marrë pjesë në hetimet e bëra nga prokurori, përkundër kërkesave të shumta me shkrim.
- Aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në prova të papranueshme në kundërshtim me nenin 386 paragrafin 1 të KPPK-së (prova në 'vrasjen e trefishtë').
- Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është në kundërthënie me arsyetimin dhe aktgjykimi nuk guxon të bazohet në supozime.
- Mbrojtja pretendon në shkelje të dispozitave të Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut.⁴

Mbrojtja pretendon në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike:

- Gjykata e shkallës së parë gabimisht mori qëndrim se provat rrethore kanë vlerë dëshmuese.
- Gjykata e shkallës së parë gabimisht vlerësoi provat e administruara, sidomos dëshmitë e M [REDACTED] I [REDACTED] provat lidhur me vrasjen e trefishtë, përgjimet telefonike, dhe alibinë e B [REDACTED] H [REDACTED], dhe nuk arriti ta përcaktojë ekzistimin e elementeve subjektive dhe objektive të veprave penale.
- Prokuroria nuk ka vazhduar të bëjë hetimin e plotë të informatave në këtë ferdë.
- Grupi i E [REDACTED] S [REDACTED] e kishte kërcënuar B [REDACTED] H [REDACTED] sa ishte polic, sipas dëshmisë së B [REDACTED] A [REDACTED]



⁴ Konventa Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e datës 4 tetor 1950.

- Dyshimet e ngritura lidhur me ekzistimin e veprës penale është dashur të interpretoheshin në favor të të pandehurit në përputhje me nenin 3 të KPPK-së.
- Aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në prova të papranueshme sepse as B [REDACTED] H [REDACTED] e as mbrojtja nuk ishin të pranishëm kur mostrat e eksplozivit ishin marrë në veturat e policisë.

C. Ankesa e ushtruar nga avokati mbrojtës A [REDACTED] I [REDACTED] në emër të të pandehurit S [REDACTED] Q [REDACTED]

Mbrojtja ushtroi ankesë për shkak të:

- Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; dhe
- Shkeljes së ligjit penal

Ai i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta pranojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar, ta lirojë të pandehurin ose ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në shkallë të parë për rigjykim.

Mbrojtja pretendon në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale:

- Aktgjykimi i kundërshtuar bazohet në prova të papranueshme në kundërshtim me nenin 153 paragrafin 2, nenet 156 dhe 157 dhe nenet 175 dhe 176 të KPPK-së.⁵
- Gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 386 paragrafit 1 të KPPK-së kur ka vlerësuar provat e lëndës së vrasjes së trefishtë pasi që aktgjykimi i kundërshtuar tejkalon aktakuzën.
- Aktgjykimi i kundërshtuar është konfuz dhe i pakuptueshëm sa i përket fakteve vendimtare dhe rrethanave të tjera lidhur me veprat penale (p.sh. motivi).

Mbrojtja pretendon në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike:

- Gjykata e shkallës së parë gabimisht vërtetoi gjendjen faktike në bazë të provave rrethore.
- Gjykata e shkallës së parë i bazoi gjetjet e saj në dëshmitë e dëshmitares M [REDACTED] I [REDACTED] në mesazhet telefonike në mes saj dhe F [REDACTED] S [REDACTED] në provat lidhur me vrasjen e trefishtë dhe në gjetjet e ekspertizës së gjurmëve të eksplozivit në veturat 093-KS-073 dhe 093-KS-029.
- Dëshmitë e dëshmitarëve lidhur me shpërthimin, rrethanat e shpërthimit dhe përfshirja e të pandehurve janë kundërthënëse.
- Dëshmitë e S [REDACTED] Q [REDACTED] janë bindëse dhe vërtetohen me anë të dëshmimeve të të bashkëpandehurve dhe dëshmitarëve dhe me prova materiale.

Mbrojtja pretendon në shkelje të ligjit penal për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Veprimet që ndodhën në shtator 2007 mund vetëm të përcaktohen si shkaktim i rrezikut të përgjithshëm.

D. Përgjigja e PSRK-së

⁵ Dëshmitë e dëshmitares M [REDACTED] I [REDACTED] A [REDACTED] B [REDACTED], dëshmitarit OMEGA, dëshmitarit TETA, dhe gjetjet e ekspertizës



PSRK-ja i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës t'i refuzojë ankesat e të pandehurve si të pabazuara, dhe për këtë qelli, ai mbështetet në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigja ndaj ankesës së avokatit mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED] në emër të të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED]

- PSRK-ja parashtrohet se mbrojtja nuk ka prodhuar asnjë provë lidhur me pretendimin e komunikimit në mes prokurorit dhe gjyqtarit.
- Mbrojtja pretendon se vulat e prokurorisë dhe gjykatës janë të paqarta në disa dokumente pa iu referuar saktë se cilat janë ato dokumente.
- PSRK-ja konsideron se procedura e konfirmimit ishte në pajtim me dispozitat ligjore.
- Prokurori Special paraqet se komentet e kryetarit të trupit gjykues ishin të lejueshme pasi që ai ishte përgjegjës për zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor.


PSRK-ja në përgjigjen e tyre lidhur me pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale thekson:

- Mbrojtja kishte deklaruar se nuk kishin asnjë vërejtje lidhur me përbërjen e trupit gjykues.
- Sa i përket pranueshmërisë së ekspertizës së gjurmëve të eksplozivit, prokurori parashtrohet se nenet 236 dhe 237 drejtojnë lëshimin e urdhrin për ekspertizë gjatë procedurës paraprake. Sipas kësaj del se ekspertiza e kryer në Bundeskriminalamt (BKA) në Gjermani është e ligjshme dhe e pranueshme.
- Përkitazi me parashtrësën se mostrat janë marrë katër muaj pas ngjarjes kritike, prokurori vëren se mostrat dhe fibrat janë dy materiale të ndryshme. Ekspertiza mjekoligjore gjen gjurmë të eksplozivit në veturë, dhe analiza e fibrave ishte bërë për të sqaruar humbjen e fibrave që nuk lidhet me eksplozivët. Në shkurt 2008 janë marrë mostra të reja pasi që mostrat origjinale u bënë të papërdorshme pas ekspertizës së kryer në Laboratorin e Zagrebit. Me procedurën mjekoligjore të bërë në veturën 093-KS-073 në shkurt 2008 përjashtohet kontaminimi.
- Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit në rastin e vrasjes së trefishtë, ajo vetëm e ka përdorur këtë si një provë tjetër rrethore.
- PSRK-ja gjen se janë pa meritë pretendimet se arsyetimi është i pamjaftueshëm dhe se ekzistojnë kundërthënie në mes arsyetimit lidhur me përmbajtjen e dëshmive të dëshmitarëve të dhëna në procedurë dhe me përmbajtjen e këtyre dëshmive të dëshmitarëve.

Në përgjigjen lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, prokuroria parashtrohet:

- Ekzistojnë edhe elemente të tjera vërtetuese përveç mesazheve telefonike nga M [REDACTED] I [REDACTED] te F [REDACTED] S [REDACTED] p.sh. gjurmët e eksplozivit në veturën e policisë, prerësit e çelësave në shtëpinë e tij, uniformat, porosia në telefon nga S [REDACTED] K [REDACTED] B [REDACTED] H [REDACTED] në vendin e vrasjes të N [REDACTED] B [REDACTED]
- Prova rrethore mund të jetë bazë e vetme për një dënim.

Përgjigja në ankesën e avokatit mbrojtës D [REDACTED] J [REDACTED] në emër të të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED]



Në përgjigje të argumentit për shkelje substanciale të procedurës penale, PSRK paraqet:

- Prokurori me te drejtë ka përjashtuar mbrojtjen nga marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe bashkë të pandehurve sepse kjo do të rrezikonte hetimin dhe sigurinë e dëshmitarëve.
- Dëshmitarja A [REDACTED] nuk është e besueshme sikurse është vërtetuar nga trupi gjyqësor.
- Provat në lidhje me lëndën e vrasjes së trefishtë janë pranuar në mënyrë të ligjshme sipas Nenit 383 të KPPK.
- Së fundi, hetimet janë zhvilluar si duhet pasi që janë zbatuar shumë tregues.

Në lidhje me bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, Prokurori paraqet:

- Ekzistojnë shumë elemente të provave të fuqishme rrethanore.
- Ekzistojnë prova të kërcënimit dhe frikësimit të dëshmitarëve.
- Laboratori në Zagreb nuk posedon pajisje të avancuara të nevojshme për të kryer ekspertizën mjeko-ligjore sikurse laboratorit në Gjermani..
- Prova e paraqitur në mbështetje të alibisë është konstatuar të ketë mungesë besueshmërie.

Përgjigja në ankesën e avokatit mbrojtës A [REDACTED] I [REDACTED] në emër të të pandehurit S [REDACTED] Q [REDACTED]

Në lidhje me shkeljet substanciale të procedurës penale, Prokurori paraqet:

- Prova rrethanore nuk duhet të ketë peshë më të vogël sesa prova e drejtë për drejtë sikurse konsiderohet në jurisprudencë.
- Provat rrethanore të vendosura bashkë dhanë një konkluzion të fuqishëm të fajësisë kundër S [REDACTED] Q [REDACTED] deklarimi i M [REDACTED] I [REDACTED] kontakti me B [REDACTED] H [REDACTED] atë natë; dobësia e alibisë së tij; porosia në telefon e dërguar nga oficeri F [REDACTED] S [REDACTED] ditën tjetër; thirrjet telefonike të S [REDACTED] Q [REDACTED] me B [REDACTED] H [REDACTED]
- Prova e sjellë nga dëshmitarja M [REDACTED] I [REDACTED] është e një vlere dëshmuese.
- Së fundi, S [REDACTED] Q [REDACTED] ka pasur uniformë speciale në shtëpinë e tij dhe ka pasur një motiv, mjetet dhe shansin për të kryer veprat penale.

E. Mendimi i ZPShK

Prokurori i Shtetit propozon të refuzohen si të pabazuara ankesat e avokatëve mbrojtës të të akuzuarve B [REDACTED] H [REDACTED] dhe S [REDACTED] Q [REDACTED], dhe të konfirmohet aktgjykimi i shkallës së parë. ZPShK e konsideron përgjigjen e Prokurorit të PSRK si pjesë të plotë të propozimit të ZPShK.

Ankesa e avokatit mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED] e ushtruar në emër të të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED]

Në lidhje me shkeljet e dispozitave të procedurës penale, Prokurori i Shtetit paraqet:

- ZPShK e konsideron parashtrësën për ndryshimin e përbërjes së kolegjit të pa meritë pasi që mbrojtja ka rënë dakord për vendimin e kolegjit.
- Pretendimi në lidhje me komentet e Kryetarit të trupit gjyqësor sa i përket disa dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë të bëjnë me çështjen e paaftësisë dhe



duhet të jenë drejtuar në përputhshmëri me Nenet 40 dhe 42 të KPPK. Për më tepër, avokati mbrojtës nuk e provoj atë.

- Prokurori i Shtetit i referohet argumenteve të bëra nga Prokurori i PSRK në lidhje me pohimet se prova është e papranueshme dhe se aktgjykimi i kundërshtuar e tejkalon qëllimin e akuzës.
- Aktgjykimi është në përputhshmëri me kushtet ligjore të Nenit 396 të KPPK, që nuk përmban mospërputhje të tilla sikurse specifikohen nga ana e mbrojtjes, dhe se dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe logjik.

Prokurori i Shtetit i referohet përgjigjes së Prokurorit të PSRK në lidhje me pretendimin e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Për sa i përket vendimit për sanksione penale, Prokurori i ZPSHK është i mendimit se dënimi nuk është që të kundërshtohet pasi që kolegji i shkallës së parë ka vlerësuar të gjitha rrethanat që kërkohen nga Neni 64 i KPPK.

Ankesa e avokatit mbrojtës D [REDACTED] J [REDACTED] e ushtruar në emër të të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED]

Në lidhje me pretendimin për shkelje esenciale të procedurës penale, Prokurori i ZPSHK i referohet përgjigjes në ankesën e avokatit mbrojtës M [REDACTED] H [REDACTED], dhe përgjigjes së Prokurorit të PSRK.

Ankesa e avokatit mbrojtës A [REDACTED] I [REDACTED] e ushtruar në emër të të pandehurit S [REDACTED] Q [REDACTED]

Në lidhje me parashtrirat për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, Prokurori i ZPSHK i referohet vërejtjeve të bëra më lart dhe përgjigjes së Prokurorit të PSRK.

III. Gjetjet e kolegjit të Gjykatës Supreme

A. Kompetenca e Gjykatës Supreme të Kosovës


Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur për ankesat në pajtueshmëri me Nenet 26 paragrafi 1 dhe 398 dhe më tej të KPPK.

Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtueshmëri me Nenin 3 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 03/L-53 mbi Kompetencat, Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë. Më 22 maj 2012 është mbajtur një seancë e hapur. Palët janë njoftuar me rregull dhe kanë marrë pjesë në seancë.

B. Pranueshmëria e ankesave

Kolegji i Gjykatës Supreme konstaton se ankesat janë ushtruar në kohë nga personi i autorizuar dhe prandaj janë të pranueshme në pajtueshmëri me Nenin 398 paragrafi 1 të KPPK.

Aktgjykimi P nr. 488/08 është shpallur më 22 shtator 2009. I pandehuri [REDACTED] dhe avokati i tij mbrojtës A [REDACTED] I [REDACTED] kanë pranuar aktgjykimin më 22 prill 2010.



Ankesa e ushtruar në emër të të pandehurit S [REDACTED] Q [REDACTED] është regjistruar në gjykatë më 26 prill 2010.

Fletë dorëzimi i adresuar të pandehurit B [REDACTED] H [REDACTED] mban datën 7 prill 2010, pa nënshkrim. Një tjetër fletë dorëzimi tregon se B [REDACTED] H [REDACTED] ka pranuar aktgjykimin më 30 prill 2010. Avokati mbrojtës D [REDACTED] J [REDACTED] ka pranuar aktgjykimin më 12 prill 2010. Ankesa e ushtruar nga avokati D [REDACTED] J [REDACTED] është regjistruar në Gjykatën e Qarkut më 27 prill 2010. Avokati i dytë mbrojtës i B [REDACTED] H [REDACTED], M [REDACTED] H [REDACTED], ka pranuar aktgjykimin më 8 prill 2010. Ai ka ushtruar dy ankesa, respektivisht më datën 28 prill dhe më 21 maj 2010. Zarfi postar tregon se ankesa e fundit është dërguar në gjykatë më 19 maj 2010.

Të tri ankesat janë dërguar në PSRK më 21 maj 2010. PSRK ka paraqitur përgjigjen në ankesat e ushtruara në emër të të pandehurve B [REDACTED] H [REDACTED] dhe S [REDACTED] Q [REDACTED] më 1 qershor 2010.

C. Meritat e ankesave

Gjykata Supreme e Kosovës i refuzon të tri ankesat si të pabazuara duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë asnjë shkelje duke shpallur të pandehurit fajtor dhe duke i dënuar ata për veprat penale Vrasje e rëndë në kundërshtim të Nenit 147 paragrafët 4, 9, dhe lëndime të rënda trupore në kundërshtim të Nenit 154 paragrafi 1 pika 1 të KPK, që të dyja të kryera në bashkë kryerje të parapara nën Nenin 23 të KPK. Gjykata Supreme, megjithatë konstatoi se vepra penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim të Nenit 291 paragrafët 1 dhe 5 të KPK absorbohet nën Pikën 1 të Vrasje e rëndë.

Propozimi i paraqitur nga ZPShK

Me të hapur të seancës së apelit, Prokurori i Shtetit paraqiti propozimin që të mbahet shqyrtimi për të marrë prova të reja, p.sh. deklaratimet e dhëna nga i pandehuri S [REDACTED] Q [REDACTED] dhënë Prokurorit Special më 30 qershor 2011, më 23 prill dhe 11 maj 2012, në pajtueshmëri me Nenin 411 dhe 412 të KPPK.⁶ ZPShK i dorëzoi deklaratimet te kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe palëve të pranishme në sallën e gjykatës. Për më tepër, ZPShK paraqiti argumentet mbi pranushmërin e provave të tilla, për natyrën e këtyre deklaratimeve dhe për mundësinë e mbajtjes së shqyrtimit. Mbrojtja ka pasur shansin të komentojë propozimin e Prokurorit. Përveç kësaj, i pandehuri S [REDACTED] Q [REDACTED] ka sjellë disa sqarime mbi përmbajtjen e deklaratimeve të tij. Avokati M [REDACTED] H [REDACTED] si edhe S [REDACTED] Q [REDACTED] kanë sugjeruar të dërgojnë lëndën mbrapa për rigjykim. Kryetari i kolegjit ka ndërprerë seancën dhe kolegji i Gjykatës Supreme është këshilluar për propozimin. Kolegji i Gjykatës Supreme refuzoi propozimin për të mbajtur shqyrtimin. Një praktikë e zakonshme në Gjykatën Supreme është që gjykata e shkallës së dytë shqyrton gjetjet e gjykatës së shkallës së parë në seancë të hapur duke bërë vlerësimet e saja të arsyeve të ankesës bazuar në ligj dhe fakte të administruara dhe të vërtetuara gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor. Kjo është bërë pa mbajtur ndonjë shqyrtim të ri. Kodi, në Nenin 412 paragrafin 1 të tij, parasheh zhvillimin e një shqyrtimi për gjykatën e apelit në kushte të kufizuara, "vetëm kur është e nevojshme për të marrë prova të reja apo për të përsëritur provat e marra tashmë për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të

⁶ Lënda P nr.. 488/08, Procesverbali i seancës të apelit më 22 maj 2012, faqet 3 dhe më tej (Dosja e kaltër e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz 246/2010. B [REDACTED] H [REDACTED] S [REDACTED] Q [REDACTED] N [REDACTED] C [REDACTED])

plotë të gjendjes faktike, dhe kur ka arsye të vlefshme për të mos e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim." Pas shqyrtimit të deklarimeve të S. kolegji është i mendimit se ato qartë nuk përmbajnë aspekte të reja të cilat kërkojnë hapjen e shqyrtimit për të marrë prova. Në të vërtetë, i pandehuri në deklarimet e tij vetëm sa konfirmoi faktet në të cilat shkalla e parë bazoi aktgjykimin e saj. Për këtë arsye Gjykata Supreme e konsideron të panevojshme të vlerësojë vlerën provuese të këtyre deklarimeve dhe të dëgjojë të pandehurin pasi që këto deklarime nuk ndikojnë në përgjegjësinë e tij penale në këtë rast.

C.1. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale nën Nenin 403 të KPPK

Pohimi se vulat e Gjykatës së Qarkut dhe Zyrës së Prokurorit në dokumentet e shkresave të lëndës janë jo të qarta

Gjykata Supreme konstaton se pohimi i avokatit mbrojtës M. H. në lidhje me qartësinë e vulës së gjykatës dhe prokurorisë është i pabazuar. Kolegji ka verifikuar dosjet e lëndës, në veçanti ato të përmendura nga mbrojtja gjatë seancës së apelit.⁷ Ky kolegji vëren se katër vula mund të gjenden në këto dokumente si edhe emri i UNMIK-ut. Ka dy vula të gjykatës (Gjykata e Qarkut në formë të rrumbullakët që përdoret mbi nënshkrimin e gjyqtarit për të vërtetuar dokumentet gjyqësore dhe vulën Gjykatës së Qarkut për regjistrimin e dokumenteve). Dy vulat e tjera janë përdorur nga zyra e Prokurorisë: njëra në formë të rrumbullakët e vendosur mbi nënshkrimin e Prokurorit dhe një tjetër vulë e Shkrimores që përmban Shkrimorja e Degës Penale. Vulat janë të ndara qartë. Për më tepër gjatë kohës së hetimit, që është e njohur edhe për mbrojtjen, me lëndën është marrë Prokurori i UNMIK-ut dhe gjyqtarët e UNMIK-ut dhe mundë të duket konfuze pasi që emri i UNMIK-ut është i pranishëm edhe në dokumentet e prokurorisë edhe të gjykatës.


Pohimi se gjykata nuk është formuar si duhet

Kolegji i Gjykatës Supreme e refuzon argumentin e mbrojtjes në lidhje me ndryshimin në përbërjen e kolegjit të shkallës së parë. Pjesa e parë e Nenit 345 paragrafi 1 përcakton rregullin e përgjithshëm që në rast të ndryshimit në përbërjen e kolegjit procedimi do të fillojë rishtas. Megjithatë, fjalia e dytë e këtij paragrafi lejon vazhdimin e gjyqimit nga ana e kolegjit të caktuar rishtazi, pra duke hequr dorë për të përsëritur marrjen në pyetje të dëshmitarëve apo të tjerëve, më tepër sesa të lexuarit e deklarimeve të dëshmitarëve dhe të dhënave të inspektimit të vendit. Ri-fillimi i gjyqimit, si pasojë, nuk është i natyrës së detyrueshme.

Interpretimi i arsyeshëm i normës duke kombinuar me formulimin e dispozitës ("mund"), shpie tek konkluzioni që kolegji nevojitet që të mos përsëris hapat procedural që i paraprijnë marrjes së provave. Prandaj, anëtari i ri i kolegjit mund të jetë i vetëdijshëm për procedurat e gjyqimit para caktimit të tij/saj në lëndë. **Kufizimi i parimit të drejtpërdrejtë** të procedurës që këtej është i pranueshëm.

Në lëndën në fjalë, përbërja e kolegjit ka ndryshuar pasi që janë dëgjuar një numër i dëshmitarëve dhe janë paraqitur provat para gjykatës. Aktgjykimi i atakuar në mënyrë të

⁷ Dosja 15 e shkresave të lëndës, faqet 5189-5673; faqet 5194 dhe 5355



qartë i referohet këtij ndryshimi të përbërjes: “Më 19 gusht 2009, zëvendësimi i gjyqtarit vendor i është komunikuar palëve të cilat nuk e kanë kundërshtuar aplikimin e dispozitës së nenit 345 të KPPK-së. Prandaj, procesverbali i seancës së mëparshme është lexuar (interpretuar) në procesverbal. Gjatë seancës së njëjtë dëgjimore, dëshmitari D [REDAKTUAR] T [REDAKTUAR] është thirr për sëri të jap disa shpjegime mbi përgjimet telefonike.”⁸ Siç është vënë në pah në mënyrë të drejtë nga prokuroria, avokatët mbrojtës nuk kanë kundërshtuar këtë përbërje të re, as në kohën e ndërrimit të përbërjes e as në rrjedhën e mëvonshme të procedurës penale.⁹ Për më tepër, kolegji i nënshkruar konsideron që arsyeja e ankesës e kundërshton parimin e besimit të mirë, *bonae fides*. Gjatë seancës së ankesës është përmendur neni 354 deri në nenin 359 të KPPK-së nga avokati M [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR]. Për fillim, kolegji i nënvizuar nuk i gjen relevante këto dispozita sa i përket ndryshimit të përbërjes së kolegjit. Për më tepër, siç është vërtetuar nga procesverbali, Kryetari i kolegjit ka proceduar në pajtim me këto nene në fillim të gjykimit.¹⁰ Kolegji gjithashtu vëren që të drejtat e mbrojtjes nuk janë shkelur nga vazhdimi i procedurës së shkallës së parë, pasi që të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës ishin të pranishëm dhe ishin të vetëdijshëm për të gjithë hapat procedural.

Pretendimi që aktgjykimi është bazuar në prova të palejueshme

Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se pretendimet që aktgjykimi i kontestuar bazohet në prova të palejueshme, veçanërisht të raporteve të ekspertizës të urdhëruar nga prokurori janë të pabazuara.

Gjykata Supreme pajtohet me argumentet e analizave të prokurorisë sa i përket kësaj. Është e vërtetë që neni 176, paragrafi 1 i KPPK-së parashikon që analizat e ekspertit do të urdhërohen me shkrim nga gjykata. Megjithatë avokatët mbrojtës nuk kanë arritur të marrin parasysh nenin 237, paragrafin 1 i cili thotë: “Analizat e ekspertit do të urdhërohen me shkrim nga gjykata sipas propozimit të prokurorit publik, mbrojtjes ose sipas detyrës zyrtare. [...]”. Kjo dispozitë duhet të interpretohet në atë mënyrë që prokurori në fazën e procedurës paraprake është kompetent të urdhëroj analizat të ekspertit, përjashtim është bërë për ekzaminime të caktuara që përfshinë sulmin e papritur fizik, i përmendur në nenin 237, paragrafin 2 të KPPK-së i rezervuar për gjyqtarin e procedurës paraprake. Prokurori është në mënyrë primare përgjegjës për mbledhjen e provave në fazën e procedurës paraprake. Lejueshmëria e ekspertizës së tillë e urdhëruar nga prokurori dhe që vlera dëshmuuese përfundimisht është e vlerësuar nga gjykata.


Kolegji i Gjykatës Supreme është i vetëdijshëm për opinionet mospajtuese të gjyqësorit në këtë çështje.¹¹ Interpretimi i tanishëm është i arsyeshëm pasi që mund të forcoj efikasitetin dhe shpejtësinë e hetimit duke marr parasysh ndarjen e detyrave në mes të prokurorit dhe gjyqtarit. Përfundimisht, nuk i kundërvihet të drejtave të pandehurit në fazën e hershme të procedurës penale.

⁸ Lënda P nr. 488/08, aktgjykimi i shkallës së parë, 22 shtator 2009, faqe 6

⁹ Lënda P nr. 488/08, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 19 gusht 2009, faqet 2 dhe 3 dhe ato në vijim (dësja kaltër P nr. 488/08 B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe të tjerët, procesverbali)

¹⁰ Lënda P nr. 488/08, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor 25 maj 2009, faqet 3 dhe 4 dhe ato në vijim (dësja e kaltër P nr. 488/08 B [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR] dhe të tjerët, procesverbali)

¹¹ Për shembull, lënda e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, GJJP nr. 210/09, aktvendim mbi kërkesën për ekspertizë, 28 prill 2009



Përsëri, Gjykata Supreme nuk gjen ndonjë shkelje substanciale të dispozitave të ligjit të procedurës sa i përket raportit të ekspertizës të bazuar në mostrat që janë marrë disa muaj pas ngjarjes. Mbrojtja mund të kontestoj vlerën dëshmuese të provave të bazuara mbi mostrat e nxjerra, por jo lejueshmërinë e saj.

Jashtë shkresave të lëndës, mund të vërtetohet që prokurori lëshoi urdhër për ekspertizë në tetor të vitit 2007. Ekspertiza është zhvilluar nga Laboratori i Krimit në Zagreb, Kroaci, për të ekzaminuar provën e radhitur në dy lista (tamponët e detektimit të eksplozivit në 8 veturat nga Gjilani dhe 7 nga Ferizaj) dhe të identifikimit të llojit të eksplozivit dhe të verifikimit të përshtatjes së mundshme.¹² Eksperti nga Qendra e Mjekësisë Ligjore Ivan Vucetic në Zagreb përfundoi që provat materiale nuk kanë paraqitur asnjë mbetje eksplozive.¹³ Duke u bazuar në këto rezultate negative, prokurori vazhdoi tek një nxjerrje tjetër e mostrës në veturat e të dyshuarit. Më 18 mars 2008, janë urdhëruar dy urdhrat për analiza të ekspertëve, duke i dhënë detyrë Institutit Gjerman të Mjekësisë Ligjore në Bundeskriminalamt (BKA) të ekzaminoj dhe të krahasoj gjurmët e fibrës dhe mostrat e pambukut.¹⁴ Më 29 shtator 2008, ekspertët e BKA-së kanë gjetur që ekziston një indikator pozitiv i pranisë së përbërësve organik eksploziv (prej tamponit të leshit të pambukut të nxjerra nga vetura me targa 093-KS-073), dhe të pranisë së PETN (nitropenta pentarythritol tetranitrate) në mostrat e marra nga veturat e PK-së.¹⁵ PShRK-ja, në përgjigjen e saj ka përmendur që procedura e pasuar nga ekzaminuesi i mjekësisë ligjore në veturën me targa 093-KS-073 në shkurt të vitit 2008 për nxjerrjen e mostrave përjashton kontaminimin.

Është vërejtur që kjo çështje është ngritur nga mbrojtja në fazën e gjykimit. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të kujdesshme konsideron kontaminimin e mundshëm të bazuar në provat e shkresave të lëndës dhe përfundon që “në bazë të kësaj informate, në mënyrë të arsyeshme nuk ekziston mundësia e kontaminimit. Dhe përfundimi i vetëm logjik është që këto gjurmë janë lënë nga sasia e eksplozivit i përdorur gjatë bombardimit, i trajtuar gjatë transportimit në vendin e përdorimit të tij. Rrethana që ato janë gjetur disa muaj pas transportimit të pretenduar në vendin e krimit e gjithashtu faktit që ekzaminimi fillestar nuk ka sjellë ndonjë rezultat, nuk e dëmton këtë konkluzion.”¹⁶

Gjykata Supreme pajtohet me gjetjet e shkallës së parë që janë bindëse: nuk ekziston indikator i kontaminimit. Gjithashtu, ekspertiza e mostrave të marra katër muaj pas ngjarjes kritike nuk ndalohet nga dispozitat e Kodit. Sipas opinionit të Gjykatës Supreme, marrja e mostrave dhe procedura e ekspertizës janë zhvilluar në mënyrë të


¹² Urdhër i Prokurorit Publik për analiza të ekspertit PPN 697-7/07 i datës 10 tetor 2007, faqe 005750 (Dosja e zezë UNMIK/Zyra e Departamentit të Drejtësisë Prishtinë, Kërkesa e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë /prokurori/urdhri i gjykatës vol. 16)

¹³ Ekspertiza e Qendrës së Mjekësisë Ligjore, I V, Zagreb, referencë nr. 511-01-43-IV/2-12782/07.MR të datës 5 nëntor 2007, faqe 003556, dosja hiri UNMIK/Zyra e Departamentit të Drejtësisë në Prishtinë, Prokurori Publik i Qarkut (Dosja e Mjekësisë Ligjore vol. 12)

¹⁴ Urdhri i Prokurorit Publik për analiza të ekspertit PPN 697-7/07 të datës 18 mars 2008, faqe 005849; Urdhri i Prokurorit Publik për analiza të ekspertit PPN 697-7/07 të datës 18 mars 2008, faqe 005857 (Dosja e zezë UNMIK/zyra e Departamentit të Drejtësisë në Prishtinë, kërkesa e gjykatës së qarkut/prokuror/urdhër i gjykatës vol. 16)

¹⁵ Opinioni i ekspertit zyrtar të datës 29 shtator 2008, AZ KT 16-2008/1621/2, kërkesa për ekzaminim nga seksioni i BKA-së ZD 32 të datës 26.03.2008, nr. i ref.YU/070924A (Dosja e zezë B H P nr. 488/08)

¹⁶ Lënda P nr. 488/08, Aktgjykimi i shkallës së parë, 22 shtator 2009, faqe 41



plotë nga policia dhe prokurori. Për më tepër, mbrojta nuk paraqet asnjë element që ti pakësoj këto të gjetura.

Pretendimi që aktgjykimi ka tejkalluar shtrirjen e akuzës (neni 386, paragrafi 1 i Kodit të tanishëm)

Gjykata Supreme gjithashtu refuzon pretendimin e mbrojtjes që aktgjykimi i atakuar është i bazuar në gjendjen faktike që tejkalon atë që përshkruhet në aktakuzë në shkellje të nenin 386, paragrafit 1 të KPPK-së.

Aktakuza PPN - KTR nr. 697-7/07 - PP - KT nr. 61-6/08 në mënyrë të qartë lidhet me eksplozimin që ka ndodhur në bulevardin Bill Clinton në Prishtinë më 24 shtator 2009. Gjykata e shkallës së parë ka ftuar dëshmitarët, p.sh. A. B., dhe ka vlerësuar provat e dorëzuara nga prokuroria, që i përket lëndës së vrasjes së trefishtë. Siç është vënë në pah në mënyrë të rregullt nga prokuroria, gjykata e shkallës së parë kishte të bëjë vetëm me këtë lëndë pasi që ka konsideruar që viktimat ishin vrarë për shkak të dijenisë së tyre për bombardimin dhe të kryerësve të këtij akti kriminal. Gjykata e Qarkut ka kufizuar fushën e shqyrtimit të provave në lëndën e vrasjes në këtë pretendim që, “N. B. ishte djalë i ri, i cili sipas pretendimit të prokurorit, i ka njohur anëtarët (së paku disa prej tyre) e grupit që kanë vendosur bombën në restaurant Sekiraqa dhe ishte informuar lidhur me planifikimin e bombardimit që nga koha ku i është ofruar të bëhet pjesë e komplotit. Në pretendimin e prokurorit, ai ishte caku (caku i vetëm) i sulmit i cili ndodhi tri ditë pas eksplozimit; motivimi i sulmit ishte që N. B. në disa ditë në mes të eksplozionit dhe vdekjes së tij në mënyrë të pamatur fliste përreth lidhur me atë se çka dinte për bombardimin.”¹⁷ Është vërejtur që trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në mënyrë të gjerë ka shtjelluar për ‘lëndën e vrasjes së trefishtë’¹⁸ në aktgjykimin e saj si “si pjesë tjetër themelore e provës rrethanore”.¹⁹ Siç është paraqitur në dispozitiv dhe në arsyetim të aktgjykimit, Gjykata e Qarkut ka vendosur mbi ekzistencën e veprave penale p.sh.: eksplozimit, mbi përgjegjësinë e të pandehurve, bazuar në faktet e përshkruara në aktakuzë. Prandaj, fusha e aktgjykimit nuk tejkalon fushën e aktakuzës. Gjykata Supreme gjen se, edhe pse formulimi i përdorur në aktgjykimin e atakuar është pak i ngatërruar, vendimi i shkallës së parë ka arsyetuar me rrethanat e lëndës dhe në pajtim me rregullat themelore të gjykitimit të drejtë.²⁰

Për më tepër, Trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut dukshëm nuk ka pasur kompetencë të merret me lëndën e vrasjes së trefishtë. Pas përfundimit të hetimit, aktakuza PPS 41/09 në lëndën P Nr. 459/2009 ishte parashtruar më 2 nëntor 2009, kështu pas shpalljes së aktgjykimit në lëndën P nr. 488/08. Lënda është gjykuar në shkurt të vitit 2011, më tepër se një vit e gjysmë pas lëshimit të aktgjykimit të kontestuar.²¹ Gjykata Supreme


¹⁷ Lënda P nr. 488/08, Aktgjykimi i shkallës së parë, 22 shtator 2009, faqe 21

¹⁸ Vrasja e N. B., U. dhe S. B. në natën e 27 shtatorit 2007 në urën e Lepencit që ndodhet në rrugën e autostradës Prishtinë – Shkup.

¹⁹ Lënda P nr. 488/08, Aktgjykimi i shkallës së parë, 22 shtator 2009, faqet 21 dhe në vijim. Informata lidhur me vdekjen e N. B. dhe dy të tjerëve.

²⁰ Lënda P nr. 488/08, Aktgjykimi i shkallës së parë, 22 shtator 2009, faqet 22-23

²¹ Më 7 shkurt 2011, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka lëshuar aktgjykimin P Nr. 459/2009 me të cilin B. H. dhe S. Q. janë shpallur fajtor për vrasje të lëndë në kundërshtim të neneve 23, 147, paragrafit 1, pikave 3 dhe 11 të KPK-së “Sepse në mes 20.10.00 të natës në mes 27 dhe 28 shtatorit 2007 ata e kanë vrarë N. B. U. dhe S. B. në mënyrë tradhtarë në urën e Lepencit (e cila gjendet në rrugën e autostradës Prishtinë-Shkup që shpërtheu në Ishatim Soponica). [...]”



përkujton që gjyqtari që merr pjesë në kolegji duhet të veproj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, pavarësisht të ndonjë rrethane të jashtme të lëndës. Trupi gjykues nuk është i lidhur me vlerësimin e provave të bëra nga një kolegji tjetër dhe sigurisht jo nga konkluzionet preliminare të hetimit.²²

Asnjë nga dispozitat e KPPK-së nuk e parandalon kolegjin për përdorimin e provave që mund të mblidhen në lëndët tjetër. Ligji procedural ofron rregullat e përgjithshme mbi administrimin e provave gojore dhe me shkrim dhe udhëzuesit për vlerësimin e tij.²³ Kufizimet që kanë të bëjnë me lejueshmërinë dhe përdorimin e provave përshkruhen qartë në Kod, d.m.th.: neni 152, paragrafi 3 i KPPK-së. Gjykata Supreme vëren që kjo provë e kontestuar është parashtruar me rregull nga prokurori. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të lirë ka vlerësuar provat lidhur me rastin e vrasjes së trefishtë, në mes tjerash provat e paraqitura para gjykatës. Gjithashtu pajtohet me gjetjet e Gjykatës së Qarkut lidhur me rolin aktiv të trupit gjykues gjatë mbledhjes së provave dhe të vlerësimit të vlerës dëshmuese të provave me qëllim të vërtetimit të së vërtetës. Gjykata e Qarkut siguron baza faktike dhe ligjore për përdorimin e provave të tilla sipas detyrës zyrtare (përveç për dëshmitarin e përmendur në aktakuzë).²⁴

Përfundimisht, mbrojtja ka mundësi të mjaftueshme, së pari të kundërshtoj vendimin e trupit gjykues, të dëgjoj provat lidhur me lëndën tjetër dhe e dyta marrja përsëri në pyetje e këtyre dëshmitarëve dhe kundërshtimi i provave në fjalë.

Pretendimi që dispozitivi i aktgjykimit ishte i pakuptueshëm ose kontradiktor në brendi ose i papajtueshëm me arsyet për aktgjykimin; arsyetimi ishte në tërësi i paqartë ose kontradiktor në pjesë të madhe; ose lidhur me faktet materiale ekziston mospërputhje e konsiderueshme në mes të arsyetimit lidhur me përmbajtjen e dokumenteve ose materialeve të dëshmisë të dhëna në procedurë në njërin anë dhe këtyre dokumenteve apo vetë materialeve në anën tjetër


Sipas opinionit të Gjykatës Supreme, pretendimet mbi karakterin kontradiktor të arsyetimit të aktgjykimit, konfuzionit sa i përket fakteve vendimtare, dhe kontradiktës në mes të dispozitivit dhe të arsyetimit nuk qëndron prandaj edhe refuzohet si i pabazuar.

Aktgjykimi i kundërshtuar përmban të gjitha elementet e detyrueshme dhe është marrë në pajtim me nenet 391 dhe 396 të Kodit. Në veçanti, përshkrimi i gjendjes faktike dhe rrethanave të kryerjes së krimeve dhe cilësimi juridik i sjelljes kriminale janë të detajuara dhe të qarta në lidhje me secilin të pandehur për secilën veprë penale. Dispozitivi gjithashtu përmend vendimin mbi dënimin.

²² Përjashtim është neni 459, paragrafi 2 i KPPK-së: (2) Gjykata do të jetë e lidhur të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale dhe përcaktoj të gjitha çështjet me të cilat është alarmuar nga Gjykata Supreme në Kosovës.

²³ Shih *inter alia* Pjesa II, Kapitulli XIX dispozitat e përgjithshme lidhur me provat, neni 360 dhe në vijim të KPPK-së; neni 387 i KPPK-së

²⁴ Dispozitat e Kodit i japin të drejtë gjyqtarit në fazën e gjykimin të vazhdoj me mbledhjen e provave që mund të konsiderohen të nevojshme për rezultatin e procedurës; shih *inter alia* neni 360, paragrafi 5 i KPPK-së: (5) Përveç provave të propozuar nga palët apo nga pala e dëmtuar, trupi gjykues do të ketë autoritetin për të mbledhur prova që i konsideron se janë të nevojshme për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të lëndës.



Gjykata Supreme nuk gjen as paqëndrueshmëri në mes të dispozitivit dhe arsytimit të aktgjykimit e as mospërputhje të konsiderueshme sa i përket fakteve materiale në mes të arsytimit që ka të bëjë me të dhënat e dëshmimeve lidhur me përmbajtjen e të dhënave të dëshmimeve të dhëna në procedurë dhe këtyre të dhënave. Gjykata e Qarkut në mënyrë të qartë ka vërtetuar faktet në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve, të dhënave të përgjimit të thirrjeve telefonike, ekspertizave dhe provave të tjera. Aktgjykimi i kontestuar shtjellon vërtetimin faktik dhe elementet konstituive të veprës penale. Ofron një arsyetim mbi ekzistimin e veprave penale dhe përgjegjësinë e të pandehurve. Edhe pse pjesa hyrëse e vlerësimit mund të konsiderohet paksa e përgjithësuar,²⁵ shtjellimi i mëtuftjeshëm sqaron përmbajtjen kryesore të deklaratave. Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve dhe jep sqarime të gjata sa i përket kredibilitetit të këtyre dëshmitarëve dhe vlerës së dëshmisë së tyre, siç është vërtetuar me procesverbalet e gjykimit. Gjykata e shkallës së parë ka për detyrë që të bëjë vlerësim gjithëpërfshirës të fakteve dhe provave, përfshirë vlerësimin e deklaratave, për të cilën ka diskrecionin. Për arsye të lexueshmërisë së aktgjykimit, vlen të përmenden dëshmitarët të cilët gjykata i konsideron vendimtar dhe të besueshëm. Kjo nuk ngrit dyshime se deklaratat tjera nuk janë marrë në konsideratë ose qëllimisht janë lënë anash. Kjo vlen kryesisht kur rezultati i deklaratës realisht nuk kontribuon në vërtetimin e fakteve.

Pretendimi i mbrojtjes lidhur me konfuzionin sa i përket fakteve vendimtare, respektivisht motivit nuk qëndron. Gjykata Supreme vëren se gjykata e shkallës së parë i është referuar “hakmarrjes së paskrupullt dhe motiveve të tjera të ulëta” nën pikat 2 dhe 4 të dispozitivit. Është e vërtetë se në arsyetimin e aktgjykimit shkruan si në vijim: “Veprimi për karakteristikat e tij, nuk është një akt i hakmarrjes (ose jo vetëm hakmarrje), është një akt i frikësimit.”²⁶ Analiza e saktë tregon se dispozitivi nuk i referohet vetëm hakmarrjes si motiv i vetëm por gjithashtu përmend “motivet tjera të ulëta”, kryesisht të vlerësuara si “frikësim”.

Pretendimi se gjithashtu ekziston shkelje substanciale e dispozitive të procedurës penale nëse gjatë procedurës penale, përfshirë edhe fazën e procedurës paraprake, gjykata, prokurori publik ose policia kanë shkelur të drejtën e mbrojtjes.


Kolegji i Gjykatës Supreme refuzon këtë pretendim se përjashtimi i mbrojtjes nga Prokurori gjatë intervistave të dëshmitarëve dhe të bashkëpandehurve në fazën hetimore përbën shkelje substanciale të procedurës penale.

Gjykata Supreme është në dijeni të rëndësishme të drejtave të mbrojtjes të garantuara në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. KPPK-ja në nenin 77 paragrafin 3, përcakton se avokati mbrojtës ka të drejtë që të njoftohet paraprakisht lidhur me vendin dhe kohën e ndërmarrjes së çfarëdo veprimi hetimor dhe të marrë pjesë në ato.

Megjithatë, edhe pa ndalesa formale secila e drejtë ka kufizime të brendshme. Kjo vlen kur ushtrimi i të drejtës së mbrojtjes do të rrezikonte të drejtat e rëndësishme të individëve p.sh. viktimave, dëshmitarëve. Do të arsyetonte ndalesat e ushtrimit të drejtave të mbrojtjes. Prokuroria i ka sqaruar shumë mirë arsyet për përjashtimin e

²⁵ Lënda P nr. 488/08, aktgjykimi i shkallës së parë, 22 shtator 2009, faqe 11: “deklaratat e tyre janë marrë në konsideratë dhe janë lënë anash.”

²⁶ Lënda P nr. 488/08, aktgjykimi i shkallës së parë, 22 shtator 2009, faqe 13.



avokatit mbrojtës nga pjesëmarrja në intervistat e të bashkëpandehurve dhe dëshmitarëve kyç, me kërcënimet e bëra nga të pandehurit dhe vrasja e dëshmitarëve. Gjykata Supreme konsideron se pas balancimit të drejtë të të drejtave në fjalë, ky përjashtim nuk i ka penguar të drejtat e mbrojtjes. Për më tepër, mbrojtja ka pasur mundësi që të kundërshtoj mu këtë provë në një fazë të mëvonshme të procedurës.

C.2. Shkelja e ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike sipas nenit 405 të KPPK-së


Gjykata Supreme është e mendimit se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë lëndë, dhe si rrjedhojë refuzon argumentet e mbrojtjen në lidhje me këtë si të pabazuara.

Pretendimi lidhur me përdorimin dhe vlera e dhënë deklaratës së dëshmitarit M. I. pranë Prokurorit nuk është arsyetuar. Kolegji i Gjykatës së Qarkut ka vlerësuar me kujdes të gjitha deklaratat e dëshmitarëve, duke i krahasuar ato dhe ka sqaruar arsyet e gjetjeve të tyre. Kjo është prerogativë e gjykatës së shkallës së parë që të vendosë lidhur me kredibilitetin e dëshmitarëve dhe vlerësimin e provave. Për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka proceduar në mënyrë të tillë të hollësishme, e liruar nga çfarëdo shkelje. Përfundimet e nxjerra nga rezultatet e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të pandehurve janë gjithëpërfshirëse dhe të sakta.

Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, mbrojtja nuk ka demonstruar deri në çfarë mase gjykata e shkallës së parë ka dështuar në vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve në dobi të pandehurve p.sh. Dëshmitarët "Zeta", J. A. J. Nuk është vërejtur se deklaratat janë vlerësuar në hollësi. Për shembull, ato të A. J. dhe I. G. janë përdorur dhe vlerësuar. Gjykata e Qarkut ka bazuar gjetjet e saj gjithashtu edhe në gjurmët e gjetura në veturën e policisë 093 KS 073 të përmendur në deklaratën e A. J. Sidoqoftë, trupi gjykues nuk e ka përcjellë deklaratën e I. G. për shkak të lidhjeve të tij të ngushta me B. H. Gjykata gjithashtu ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve dhe të pandehurve të tjerë, por i ka konsideruar si jo të besueshme.

Kjo vlen edhe për deklaratën e B. H. në lidhje me alibinë e tij. Sa i përket alibisë së vetura nuk ka mundur të përdoret nga të pandehurit, Prokuroria argumenton se dëshmitarët kanë dëshmuar se regjistri i udhëtimeve dëshmon një tjetër huazues të veturës gjatë vikendit kritik në fjalë i kanë tërhequr deklaratat e tyre të para gjatë intervistimit.

Ata kanë ndryshuar deklaratat e tyre duke pohuar se është bërë një gabim në dokumentacionin e parë. Një dëshmitar tjetër, I. G. ka pranuar se procedura e pranim dorëzimit nuk janë gjithmonë në përputhje me regjistrin e udhëtimeve, dhe veturat në realitet kanë mundur të jenë shfrytëzuar nga të tjerët në vend të listuar në regjistrin e udhëtimeve. E njëjta vlen për deklaratën e A. A. Ajo qantazi nuk është dëshmitare e besueshme kur ka deklaruar se natën kritike e ka kaluar me B. H. edhe pse ka të dhëna të thirrjeve telefonike në mes të dyve të cilët kanë qenë në kontakt gjatë kohës së njëjtë. Gjykata e shkallës së parë gjithashtu në mënyrë të besueshme ka arsyetuar se të dy vajzat e dëshmitares M. I. dhe vetë M. I. ka qenë nën kërcënime nga të pandehurit, dhe prandaj besueshmëria e tyre ka qenë e dyshimtë.



Duke marrë parasysh atë që u tha më lart, të gjitha pretendimet e mbrojtjes lidhur me gjoja vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike nuk janë të arsyetuara.

Gjykata e shkallës së parë ka dënuar të dy të pandehurit për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm në kundërshtim të nenit 291 paragrafëve 1 dhe 5 në lidhje me nenin 23 të KPK-së, pasi që “më 24 shtator 2007, B. H. dhe S. Q. duke vepruar në bashkëkryerje me njëri tjetrin dhe me individë identiteti ti të cilëve ende nuk është i njohur, duke përdorur eksploziv, përkatësisht një mjet të improvizuar shpërthyes kanë vendosur dhe shpërthyer në katin përdhese të një ndërtese në bulevardin Bill Kllinton, Prishtinë, kanë shkakuar rrezik të madh ndaj jetës së njerëzve duke rezultuar në vdekjen e dy personave N. M. dhe P. S. dhe lëndime të rënda trupore të nëntë personave X. S., V. Z., L. N., G. S., E. H., N. H., F. B., L. K., S. S. M. K. dhe T. K. dhe dëme të konsiderueshme materiale në prona, përkatësisht në lokalet e C., B., U., S., O., P., N., K., F. C. dhe S.” Neni 291 paragrafi 1 përcakton si në vijim: “Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë e një rëndësie thelbore dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.”

Gjykata Supreme është e mendimit se akti i shkakimit të rrezikut të përgjithshëm është absorbuar nga sjellja kriminale e Vrasjes së rëndë pasi që vepra penale është konsumuar nga vepra penale Vrasje e rëndë sipas paragrafit 4 të nenit 147. Prandaj, Gjykata Supreme vepron sipas detyrës zyrtare sipas nenit 389 paragrafit 3 dhe nenit 415 paragrafit 1 pikës 1 të KPK-së.


C.3. Vendimi mbi sanksionimin penal sipas nenit 406 të KPPK-së

Gjykata Supreme konstaton se dënimi i shqiptuar prej njëzetepesë (25) viteve ndaj të pandehurve është i arsyeshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të lëndës dhe objektiven e përgjithshme të dënimit për këtë qëllim. Pretendimi i mbrojtjes në lidhje me këtë, refuzohet.

Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, të dy të pandehurit kanë kryer vepra penale të rënda të cilat kërkojnë burgim afatgjatë siç është paraparë me nenin 147 të KPK-së. Gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar burgim në minimumin e shkallës së përcaktuar me ligj sipas nenit 37 paragrafit 2 të Kodit, p.sh. prej njëzetepesë (25) vite deri në dyzet (40) vite. Burgimi prej njëzetepesë (25) vite është i domosdoshëm për të përmbushur qëllimin e dënimit të përcaktuar me nenin 34. Dënimi unik i shqiptuar ndaj të dy të pandehurve është në pajtim me kushtet e nenin 71 paragrafit 1, pikës 1 të KPK-së.

I pandehuri S. Q. ka dhënë një deklaratë duke konfirmuar përgjegjësinë e tij për krimet e kryera nga dy të pandehurit. Gjatë seancës ankimore, Prokurori i shtetit ka paraqitur propozimin për zvogëlimin e dënimit ndaj S. Q. duke shprehur keqardhjen e tij në atë kohë dhe gatishmërinë e tij për ta mbështetur Prokurorinë.

²⁷ Lënda P nr. 488/08, procesverbali i seancës ankimore 22maj 2012, faqet 21-22 (Dostia e Kallër Gjykata Supreme e Kosovës Ap-Kz 246/2010, B. H. S. Q. N. C.)



Gjykata Supreme nuk ka paraqitur deklaratën në procedurën ankimore sepse i pandehuri Q. ka konfirmuar se nuk do ta pranoj fajësinë për shkak të kinse vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike në aktgjykimin e kundërshtuar. Për më tepër, rezultati i procedurës së shkallës së parë nuk është bazuar në deklaratat e tij të dhëna në një fazë të mëvonshme. Deklaratat e tij të paraqitura nga Prokurori i shtetit mund të jenë të rëndësishme në procedurat tjera kundër tij. Prandaj, propozimi refuzohet.

D. Shpenzimet e procedurës ankimore

Shpenzimet e kësaj procedure ankimore do të mbulohet së bashku nga të dy të pandehurit sipas neneve 99, 100 dhe 103 të KPPK-së në lidhje me nenin 414 të KPPK-së.

Kryetar i kolegjit:

Dr Horst Proetel
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Tore Thomassen
Gjyqtar i EULEX-it

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Procesmbajtës:

Adnan Isufi
Këshilltar ligjor

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Anne Kerber
Gjyqtare e EULEX-it

Gjykata Supreme e Kosovës
AP-KZ 246/2010
25 maj 2012
Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
FAKTËSIME E KOPJËS E VËRTETON
ФАКТНОСТ ОТПРАВКА ПОТВРЂУЈЕ

Punëtori i autorizuar
Оријасени радник